FEDERATA E RAGBIT E KOSOVËS

VENDIM I BORDIT

Data e mbledhjes: 13.10.2026

Bordi i Federatës së Ragbit të Kosovës (FRK), në mbledhjen e mbajtur më 13 tetor 2026, pas shqyrtimit dhe diskutimit të pikave të rendit të ditës, mori këto vendime:

Vendimi Nr. 1 – Organizimi i Kampionatit Shtetëror

Miratohet organizimi i Kampionatit Shtetëror të Ragbit, në përputhje me planin e paraqitur nga Drejtori i Ragbit.

Kampionati do të zhvillohet në datat:

- 25 tetor 2026
- 1 nëntor 2026
- 22 nëntor 2026

Drejtori i Ragbit ngarkohet me koordinimin dhe zbatimin e planit të organizimit të kampionatit, në bashkëpunim me klubet pjesëmarrëse dhe strukturat përkatëse të Federatës.

Vendimi Nr. 2 – Implementimi i Planit të Aktiviteteve për të Rinj

- Miratohet implementimi i planit të aktiviteteve dhe kampeve për të rinj, sipas propozimit të paraqitur nga Drejtori i Ragbit.
- Kampi i parë ndërkombëtar për të rinj do të fillojë më 7 nëntor 2026.
- Drejtori i Ragbit ngarkohet me koordinimin e aktiviteteve dhe zbatimin e planit të miratuar, në bashkëpunim me strukturat përkatëse të Federatës.

Vendimi Nr. 3 – Angazhimi i Zyrtarit për Zhvillimin e Ragbit në Rajonin e Dukagjinit

- Miratohet angazhimi i një Zyrtari për Zhvillimin e Ragbit (*Development Officer*) në Rajonin e Dukagjinit, duke filluar nga janari 2027.
- Angazhimi ka për qëllim zgjerimin e aktiviteteve të ragbit në rajon, mbështetjen e klubeve ekzistuese, promovimin e ragbit në shkolla dhe rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe të rinjve në këtë sport.
- Strukturat përkatëse të Federatës ngarkohen me ndërmarrjen e hapave të nevojshëm për realizimin e këtij vendimi.

Për Federatën e Ragbit të Kosovës

Dardan Gashi
President

